

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA SHTIME**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **617-24-964-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **Ndertimi i objektit të Komunës**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	LIMITPROJECT SH.P.K.
NUI	811312561
Adresa	Rr. Ahmet Gashi H1, L3,1
Vendi	Prishtinë
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Lulzim Zaraj
Adresa elektronike	limitproject.shpk@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	28.06.2024

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Ndertimi i objektit të Komunës

Njoftimi për kontrate 12.06.2024

Kerkese për rishqyrtim 18.06.2024

refuzimi i kerkeses për rishqyrtim 20.06.2024

Dorezimi i parashikuar i tenderit 08.07.2024, ora 14.00

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Ne kemi paraqitur kerkese për rishqyrtim me datën 18.06.2024. AK ka refuzuar kerkesen për rishqyrtim me date 20.06.2024

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 - qellimi

- Neni 6 - Ekonomiciteti dhe efikasiteti
- Neni 7 - Barazia ne trajtim - mosdiskriminimi
- Neni 69 - Aftesia teknike dhe ose profesionale

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjohë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejtshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. *Sipas kërkesës mbi mundësit teknike dhe profesionale Kërkesa 4 Staf i profesional pika C- inxhinier ndërtimi - drejtimi infrastrukture rrugore: Pse do të duhej të kërkoj një inxhinier i drejtimin të infrastrukturës rrugore përderisa ky është një objekt i lartë dhe jo objekt infrastrukturor.*
2. *Një master i emergjencave - i licencuar nga MPMS, në si kompani e kemi inxhinierin e tillë, mirëpo pse do të duhej të ishte një inxhinier kur lehtësisht mund të ishte bachelor dhe e kufizon shumë pjesëmarrjen, ose në këtë rast, MFTP (Ministria e Financave dhe Transfereve dhe Punës) i trajnon dhe certifikon inxhinieret e ndërtimit, të makinerisë e të ndryshëm si ekspert të sigurisë dhe shëndetit në punë. Pse të kufizohet në master të shkencave të emergjencave kur lehtësisht edhe inxhinieret e certifikuar kanë këto kualifikime.;*
3. *Pse do të duhej të kërkohej CV e noterizuar, kur shumica e noterëve nuk e noterizojnë, përderisa është kërkuar kontrata e noterizuar, diploma e noterizuar etj.*
- 4.

Sipas kërkesës mbi mundësit teknike dhe profesionale Kërkesa 5 -Pajisjet:

1. *Ekskavator me cekan 8 deri 10 ton, ky është një kufizim i panevojshëm dhe po i njëjti ekskavator është kërkuar si kriter në procedurat e lumenjëve dhe të tjera, dhe tani edhe në ndërtim dhe këtë pajisje mund ta posedojnë një numër shumë i kufizuar i kompanive;*
2. *Makineri për shpim horizontal në rrugë – 2 copa, pse do të duhej të jenë 2 copa, kur nuk do të jenë aktive të dyjat?!*
3. *Prerese betoni dhe asfalti, minimum 3 copa – pse do të duhej të jenë 3 copa në ndërtim të lartë përderisa nuk është renovim por ndërtim i ri;*
4. *Makinë hidraulike që vendoset në ekskavator për hapjen e kanaleve me sistem zingjiror – minimum 1 cope, këtë pajisje mund ta posedojë vetëm një kompani në Kosovë dhe pse do të duhej të hapej kanali me vetëm këtë makineri, dhe a mund të na sqaroni për cilin pozicion në paramasë është parapare të përdorët kjo pajisje?!*
5. *Kamion kiper me vinç dhe korpe me kapacitet minimum 10 m³ – vinc me hapje min 20m, të dëshmohet me atest: A mund të na tregoni për cilin pozicion në paramasë do të përdorët kjo pajisje përderisa e kufizon kaq shumë;*
6. *Kompresor gjysëmrimorkio që tërhiqet me peshe minimum 1.5 ton, ju lutem të na sqaroni për cilin pozicion është i domosdoshëm kjo pajisje;*

7. *Ekskavator me gome – maksimum 6 ton, ju lutemi a na e sqaroni a është ekskavator me zingjire gome apo me rrota goma – dhe është shume i kufizuar numri i ekskavatorët me rrote gome me këtë peshe janë shume pak ne tregun e Kosovës. I njëjti kriter është kërkuar nga ana juaj edhe ne procedurat tjera si rruge, lumenj, kanalizime etj?!*
8. *Luge ngarkuese me pirun dhe fshese – maksimum 7 ton, kjo pajisje është shume e rralle dhe është kriter diskriminues ku ne vete bëjmë ndërtime te larta dhe asnjëherë nuk na është dashtë kjo pajisje, ju lutemi na sqaroni këtë kriter se cili pozicion nuk mund te kryhet pa këtë paisje?!*

Prandaj, kerkojme nga AK, qe te krijoje mundesite per pjesmarrje me te gjere dhe jo vetem nje kompani e cila do te krijonte monopol.

Te nderuar OSHP - anetare te panelit shqyrtues, ta keni parasysh se ne kemi paraqitur kerkesen per rishqyrtim me tekstin e mesiperme prane AK, mirepo nuk e kane marre parasysh kerkesen tone per rishqyrtim.

JKerkojme nga ana juaj qe te merrni VENDIM per rishikimin e dosjes se tenderit dhe te krijohen kushtet per pjesmarrje me te gjere ne kete gare.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Nuk kemi pretendime ne kete faze.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) *një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) *një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*